



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 08 /L-235

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 08/L-193 MBI
NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
PËR VITIN 2023 I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 08/L-
213**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65, paragrafëve (1) dhe (5) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ NR. 08/L-235 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.
08/L-193 MBI NNDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS
SË KOSOVËS PËR VITIN 2023 I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME
LIGJIN NR. 08/L-213**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të ndryshojë dhe plotësojë Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-213.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e këtij Ligji janë të detyrueshme për të gjitha organizatat buxhetore dhe njësitë përkatëse të tyre brenda fushëveprimit të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2023.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Ligj kanë kuptimet si në vijim:

1.1. **Ligji Bazik** – nënkupton Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-213.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Ligj kanë kuptimin e përcaktuar sipas Ligjit Bazik.

Neni 4

Paragrafi 6, i nenit 9 të Ligjit Bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

6. Bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të komunave nga viti fiskal 2022 dhe vitet paraprake, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një komunë, ndahen për vitin fiskal 2023 sipas autorizimeve të LMFPP-së, duke ruajtur strukturën e shpenzimeve dhe aprovuar me vendim të Kuvendit të Komunës.

Neni 5

1. Në tabelën 3.1 të Ligjit Bazik bëhen ndryshimet ashtu që nën programi buxhetor me kod 02000, “Zyra për Çështjet e Trashëgimisë së TMK”, në kuadër të organizatës buxhetore Ministria e Mbrojtjes, me kod 217, së bashku me numrin e të punësuarve dhe buxhetin përkatës, barten si nën program i veçantë buxhetor në kuadër të organizatës buxhetore Ministria e Punëve të Brendshme, me kod 214, në kuadër të programit buxhetor “Shërbimet e Administratës Qendrore” me kod 11314, në kategorinë e njëjtë të shpenzimeve.
2. Shpenzimet e realizuara nga Ministria e Mbrojtjes në kuadër të nën programit buxhetor me kod 02000, deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji do të njihen dhe llogariten si shpenzime të realizuara me rastin e bartjes sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Përveç shpenzimeve që barten nga paragrafi 1 i këtij neni, bartjes tek organizata buxhetore i nënshtrohen të gjitha transaksionet në SIMFK, në të njëjtin status të ekzekutimit të buxhetit në të cilin gjinden aktualisht me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Ekzekutimi i të gjitha shpenzimeve do të bëhet nga Ministria e Punëve të Brendshme me kodin buxhetor 214 në përputhje me planifikimet dhe buxhetin.
4. Aspektet e tjera procedurale të bartjes dhe raportimit mund të rregullohen me vendim të Ministrit.

5. Bartjet e specifikuara në paragrafin 1 të këtij neni nuk i nënshtrohen kufizimeve të vendosura në nenin 30 të ligjit përkatës për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-235
8 qershor 2023

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës